



Titulli i projektit

Qendra sociale për të moshuar

Tipi i projektit

Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja
e projektit

Të 4 NJQV e ZF Shijak

Buxheti i paravlerësuar

130,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza
e problemit/eve

Një nga problemet e evidentuara nga analiza e Zonës Funksionale Shijak është edhe mungesa e qendrave kulturore dhe rekreative për të gjithë popullsinë. Kjo gjendje është kritike për moshën e tretë, sidomos gjatë ditëve të dimrit, kur për shkak të kushteve atmosferike është e vështirë të gjenden hapësira dhe mundësi për kalimin e kohës dhe për argëtim. Asnjë nga NJQV nuk ka ambiente të dedikuara për të orfuar shërbime të kësaj natyre, të orientuara drejt anëtarëve të popullsisë në moshën e tretë.

Qëllimi/et specifik
të projektit

Objektivi i këtij projekti është të krijohet premisa për të ofruar shërbime sociale për moshën e tretë në disa qendra rekreative. Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, përfaqësuesit e moshës së tretë, një kategori shoqërore e marxhinalizuar, do të merrnin vëmendjen e duhur, përkujdesje publike dhe do të kishin në dispozicion ambiente të përshtatshme për të kaluar kohën në mënyrë të kulturuar. Nga ana tjetër ky projekt do të ishte një shërbim publik i shtuar dhe i përmirësuar në mbështetje të moshës së tretë.

Rezultatet e pritshme
dhe treguesit

Të gjitha NJQV e Zonës Funksionale Shijak do të përfitonin njëloj nga zbatimi i këtij projekti, në veçanti ajo pjesë e popullsisë që përbën moshën e tretë dhe që vazhdimisht nuk e ka vëmendjen e qeverisjes vendore dhe është një grup i marxhinalizuar. Me zbatimin e këtij projekti hapen katër qendra sociale për moshën e tretë dhe pajisen me mjetet e duhura për të ofruar shërbime të përshtatshme, duke sjellë kështu përmirësim të ndjeshëm të shërbimeve publike në zonë.

PROJEKTI 8



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Ky projekt me kohëzgjatje 2-vjeçare përfshin këto aktivitete:

- Identifikimi dhe rikonstruktimi i ambienteve të përshtatshme për krijimin e katër qendrave sociale për të moshuarit.
- Pajisja e ambienteve me mjetet e nevojshme për të ofruar shërbimet e përshtatshme për të moshuarit
- Promovimi i qendrave
- Funksionimi ditor i qendrës
- Kremtimi i ditëve festive, etj.

Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimi i këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor dhe biznesin lokal.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë mundësitë kufizuara financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohet financim nga donatorët e huaj ose vendas.

Shoqëria civile, në partneritet me pushtetin vendor, do të ishte aktori më i përshtatshëm për zbatimin e këtij projekti, duke marrë në konsideratë edhe përvojën e grumbulluar ndër vite dhe rolin e tyre të natyrshëm në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Kostot e projektit

Identifikimi dhe rikonstruktimi i ambienteve të përshtatshme për krijimin e katër qendrave sociale për të moshuarit	40,000
Pajisja e ambienteve me mjetet e nevojshme për të ofruar shërbimet e përshtatshme për të moshuarit	10,000
Promovimi i qendrave	2,000
Funksionimi i rregullt i katër qendrave për dy vjet kohëzgjatje	60,000
Programë rehabilitimi dhe kujdes shëndetësor i avancuar	14,000
Kremtimi i ditëve festive, etj.	4,000